



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:193756
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05446572

CA.nr.2618/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Nora Bllaca-Dula dhe Fatmir Baloku, antarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve A.Sh., E. B. dhe E. R., që të tre me vendbanim në Prishtinë, përfaqësuar nga av. I. R., nga Gj., rr. xxxxx, me datë 12.09.2023, kundër të paditurit/kundërshtarit e sigurimit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me seli në Prishtinë, sipas padisë për anulimin e Vendimit nr.01/774, datë 28.07.2023, dhe konstatim të diskriminimit, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga paditësit përmes të autorizuarit të tij avokat I. R. nga Gj., kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.5063/23, të datës 18.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt **13.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET SI E BAZUAR ankesa e paditësve A. Sh., E. B. dhe E. R. të tre nga Prishtina, ushtruar përmes të autorizuarit të tyre, avokat Ilir Rugova nga Gjakova, **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.5063/23, i datës 18.09.2023, dhe çështja i kthehet në **ri vendosje**, gjykatës së shkallës së parë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin e ankimuar C.nr. 5063/23, data 18.09.2023, ashtë seancës, ka vendosur si në vijim:

- I. Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, shpallet **JOKOMPETENTE** në pikëpamje lëndore për të vendosur në çështjen juridike kontesitmore sipas padisë së paditësve C.nr.5063/23, e datës 12.09.2023.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi, shkresat e kësaj lënde t'i dërgohen Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si gjykatë me kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me çështjen.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, ankesë kanë ushtruar paditësit përmes të autorizuarit të tyre, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vendosur që shpallet inkompetente në rastin konkret, për faktin se mbi bazën e Ligjit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit dhe legjislacionit në fuqi, çështja duhet të trajtohet sipas dispozitave të procedurës kontestimore nga gjykata kompetente e divizionit civil, e në këtë kuptim ka pretenduar se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave ligjore lidhur me kompetencën lëndore mbi bazën e kësaj i ka propozuar gjykatës së shkallës së dytë që të anulohet aktvendimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në ri vendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk është ushtruar nga e paditura.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të ankesës, provave në shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209, pika (d) të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësve A.Sh., E. B. dhe E. R. të tre nga P., ushtruar përmes të autorizuarit të tyre, avokat Ilir Rugova, rezultoi e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit me datën 12.09.2023, në gjykatën e shkallës së parë kanë ushtruar padi kundër të paditurës Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me seli në Prishtinë për anulimin e pjesërisht të vendimit të të paditurës nr. 01/774/, të datës 28.07.2023, respektivisht pikës 10 të këtij vendimi ku iu ndalohet paditësve angazhimi me orar jo të plotë në kolegje private, duke kërkuar njëkohësisht nga gjykata që ti ndalohet të paditurës të kryej veprime diskriminuese ndaj paditësve dhe të eliminohet çdo veprim i të njëjtës me të cilin paditësit i diskriminon apo ua rrezikon marrëdhënien e punës, si dhe kanë kërkuar shpenzimet e procedurës, njëkohësisht kanë kërkuar edhe caktimin e masës së sigurimit si në përmbajtje të propozimit.

Gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të padisë së paditësve, shqyrtimit paraprak të saj, jashtë seancës gjyqësore nxjerr aktvendimin e ankimuar me të cilin shpallet inkompetente në pikëpamje lëndore për trajtimin e kësaj çështje, dhe pas plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi vendos që lënda ti dërgohet në kompetencë lëndore Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Në arsyetimin e saj lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se kemi të bëjmë me kërkesë për anulim të Vendimit nr.01/774, datë 28.07.2023, të nxjerrë në procedurë administrative nga organet kompetente të të paditurës, gjegjësisht anulimit të aktit administrativ me të cilin është vendosur në çështjen juridike ka karakter të përgjithshëm, për qëllimet teknike organizative dhe me të njëjtin nuk është preku marrëdhënia e punës së paditësve. Gjykata konsideron se në rastin e paditësve, padia është dashur të adresohet në Departamentin për Çështje Administrative si departament kompetent, pasi që objekt shqyrtimi është vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit të të paditurës, i cili është kërkuar të anulohet si i tillë, nga paditësit si të punësuar pranë të paditurës, e me të cilin nuk i është shkelur, apo cenuar e drejta e tyre nga marrëdhënia e punës.

Sipas nenit 17, par. 1 të Ligjit Nr. 06/L - 054 për Gjykatat, “*Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.*”

Me nenin 13, par. 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) është paraparë që “[k]onflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë”, dhe “2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.” E, sipas nenit 3, par. 1.2 të LKA, akt administrativ është “çdo vendim të organit të paraparë në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi, i cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërisht, liritë ose interesat e personave fizikë ose juridikë përkatësisht palës tjetër në vendosjen e çështjes administrative.”

Duke qenë se bazuar në Ligjin mbi Gjykatat, për kontestet e kësaj natyre, Gjykata Themelore në Prishtinë, përkatësisht Departamenti i Përgjithshëm i saj, nuk ka kompetencë lëndore, kjo gjykatë gjeti se për çështjen në fjalë, e njëjta duhet të shpallet inkompetente në pikëpamje lëndore dhe se kjo lëndë duhet t’i dërgohet Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si gjykatë me kompetencë lëndore.

Në përputhje me nenin 19 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), “[s]ecila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën lëndore”.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, rezulton se kjo gjykatë – Departamenti i Përgjithshëm -, është jokompetente lëndore për vendosjen lidhur me kërkesën e paditësit, prandaj për këtë arsye e në bazë të nenit 19 dhe nenit 29 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe se aktvendimi i atakuar edhe pse nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) në lidhje me nenin 194 të LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, megjithatë i njëjti aktvendim duke iu referuar përmbajtjes së ankesës së parashtruesit të saj lidhur me shkeljet e gjykatës së shkallës së parë për inkompetencën lëndore gjen se në rastin konkret zbatimi i gabuar i të drejtës materiale i pretenduar nga pala ankuese në përmbajtjen e saj lidhet me pretendimet shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me inkompetencën lëndore të gjykatës së shkallës së parë, e që në rastin konkret i referohen nenit 182 par.1, pika a), në lidhje me nenin 17 par.1 dhe 2 të LPK-së, , dhe si i tillë nga gjykata ankimore është trajtuar.

Gjykata e Apelit, nga ekzaminimi i aktvendimit të goditur me ankesë, gjen se gjykata e shkallës së parë shpalljen e saj inkompetente në pikëpamje lëndore e bazon në vendimin e të paditurës nr. 01/774, të datës 28.07.2023, dhe të njëjtin e trajton si akt administrativ me karakter të përgjithshëm, duke iu referuar nenit 13 par.1 dhe 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në lidhje me nenin 17 të Ligjit për Gjykatat nr. 06/L-054, mirëpo, gjykata e shkallës së dytë me aprovimin e ankesës së paditësve, vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht është shpallë inkompetente në pikëpamje lëndore në rastin konkret, ngase vendimi i atakuar nga paditësit ka të bëjë me kufizimin e të drejtave të tyre nga marrëdhënia e punës, e që në bazë të nenit 12 par.1 të Ligjit për Gjykatat nr. 06/L-054, në lidhje me nenin 13 par.1, dhe nenin 16 të Ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, ku përcaktohet gjykata kompetente në trajtimin e rasteve të diskriminimit dhe procedura që duhet të zhvillohet para gjykatës kompetente e që duhet të jetë procedura kontestimore, prandaj, pavarësisht faktit se në marrëdhëniet e punës vendimi i punëdhënësit që atakohet është akt administrativ, megjithatë kompetentë në shqyrtimin e këtyre çështjeve është Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil dhe jo Departament për Çështje Administrative sipas nenit 13 të Ligjit për Konfliktet Administrative, sepse kërkesa e paditësve ka të bëjë me anulimin e pjesërisht të vendimit të atakuar që sipas tyre paraqet

diskriminim nga marrëdhënia e punës duke ua kufizuar të drejtën e tyre për punë dhe angazhim në kolegje private, prandaj, kjo çështje duhet të trajtohet pranë Gjykatës Themelore-Departamentit të Përgjithshëm-Divizionit Civil.

Sa i përket pretendimit ankimor të parashtruesit të ankesës që të ndërrohet gjyqtari i çështjes sipas nenit 198 par 3 të LPK-së, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjyqtari i çështjes me asnjë veprim të tij nuk ka manifestuar sjellje jo objektive që gjykatës së shkallës së dytë do ti rezultonin me ndërrimin e tij, ngase i njëjti nuk është lëshuar në seancë gjyqësore dhe se vlerësimi i tij në nxjerrjen e aktvendimit të atakuar me ankesë nuk përbën arsye për ndërrimin e tij në trajtimin e kësaj çështje juridike.

Në ri procedurë, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që fillimisht të zhvilloj procedurën lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit të parashtruar nga paditësit, e gjithashtu padinë me shkresat e lëndës t'ia dërgoj palës së paditur për përgjigje në padi dhe varësisht nga gjendja e vërtetuar faktike të vendos meritorisht në këtë çështje juridike duke specifikuar dhe vërtetuar saktë dhe plotësisht pretendimet e palëve ndërgjyqëse sipas padisë së ushtruar, ashtu që, varësisht edhe nga kundërshtimet e palës së paditur dhe vërtetimi i plotë dhe drejtë i gjendjes faktike, të nxjerr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e arsyeve të lartpërmendura, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209, pika (d) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.2618/24, me datë 13.03.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka